



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Duke u mbështetur në nenin 12 paragrafi 12.2 nënparagrafi d), nenit 40.2 nën c) të Ligjit për Vetqeverisje locale nr.03/L-040, Ligjit nr.03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit neni 30, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal si dhe nenit 40 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë së Arsimit të dt.12.04.2019, Kuvendi I Komunës së Klinës në seancën e IV të rregullt për vitin 2019, mori këtë:

V E N D I M

Transfer të mjeteve për paga fondi burimor 10

- I. Miratohët vendimi për transfer për paga në kuader të organizatës buxhetore Komuna e Klinës (634) programi Arsim dhe Shkencë kodit 920 nga nënprogrami Arsimit I mesëm kodit 9470, kodit funksional (0922) nga kategoria e pagave kodit 011, shuma 6000.00€ të transferohen në nënprogramin Arsim Fillor, kodit 93510, kodit funksional (0912) në kategorinë e pagave kodit -011. Gjithashtu, në kuader të organizatës buxhetore Komuna e Klinës (634) programi Arsim dhe Shkencë kodit 920, nga nënprogrami Arsimit Parafillor, kodit 92550 kodit funksional 90911) nga kategoria e pagave kodit 011 shuma 2500.00€ të transferohen në nënprogramin Arsim Fillor, kodit 93510 kodit funksional (0912) në kategorinë e pagave kodit 011.
- II. Transferi i mjeteve nga kategoria e pagave kërkojë për harmonizimin e mjeteve të pagave ndërmjet nënprogrameve në kuader të organizatës Arsim dhe Shkencë.
- III. Vendimi është i plotfuqishëm me miratim në Kuvendin e Komunës dhe hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyren e Protokollit të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen zyrtare të komunës, kjo në kuptim të nenit 15 dhe 16 të Rregullorës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2017, të dt.23.08.2017 për Procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.
- IV. Me vendim njoftohen: Ministria Për Ekonomi dhe Financa-Departamenti i buxheteve Komunale dhe Thesarit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit të KK të Klinës, Sherbimi për punë të Kuvendit dhe arkivi.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 601-17769 2019
Klinë, me 03.05, 2019

